

● Ndiej se po ndryshojnë aq shumë gjëra dhe nuk jam gati. Pse nuk mund të mbeten gjërat njësoj?
- Dikush që po Rritet në Granadë

I dashur Dikush që po Rritet,

Mendo për historinë tënde të parapëlqyer me aventura. Heronjtë u përballën me disa ndryshime dhe sfida të mëdha përpara se të arrinin më në fund synimin e tyre, apo jo? Po të mos ndryshonte asgjë për ta, nuk do të kishte aventura! Nuk do të kishte fund të lumtur!

Ndryshimi është i rëndësishëm edhe për historinë tënde. Është normale të ndiesh trishtim, shqetësim ose frikë. Por mbaj mend se ti je heroi ose heroina e historisë sate. Çdo ndryshim është një mundësi për të mësuar dhe për t'u rritur. Ati Qiellor do të të ndihmojë.

Paç fat në aventura të tua!

Miku

Hyr në botën e aventurës duke vizatuar veten si një hero aventurash!

